



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, nenit 17 të Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ,nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____, të miratojë këtë :

PROPOZIM

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME –LOKALEVE AFARISTE TË KOMUNËS NË ZK MAGURË

Neni 1

Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak 15Nr.464-45591 të datës 12.11.2014 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme - lokaleve afariste të Komunës në ZK Magurë përkatësisht për dy lokalet afariste të precizuara në paragrafin 1.7 të pikes 1 të Vendimit të cekur paraprak me sipërfaqe 17m² dhe 38 m² , (në vazhdim të tekstit: Komisioni), në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, prej të cilëve 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës nga përbërja e ekzekutivit të Komunës, 2 (dy) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet politike dhe 1 (një) anëtar nga sektori jo qeveritar lokal.

2. Anëtarë të Komisionit emërohen, si vijon :

1. Valon Pacolli nga ekzekutivi i Komunës,

2.Rexhep Rexhepi nga ekzekutivi i Komunës,

3. _____ nga subjektet politike,

4. _____ nga subjektet politike dhe

5. _____ nga sektori joqeveritar lokal

Neni 2
Zgjedhja e Kryesuesit

Anëtarët e Komisionit me shumicë të votave, e zgjedhin Kryesuesin e Komisionit i cili e kryeson punën e Komisionit.

Neni 3
Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak 15Nr.464-45591 të datës 12.11.2014 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme - lokaleve afariste të Komunës në ZK Magurë, përkatësisht për dy lokalet afariste të precizuara në paragrafin 1.7 të pikes 1 të Vendimit të cekur paraprak me sipërfaqe 17m² dhe 38 m².

Neni 4
Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni, për të zbatuar Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës të cekur më lartë me të cilin është vendos për pronën e cila do jepet në shfrytëzim, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5
Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me akte nëligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Zyra Kryetarit të Komunës – Sektori pronësor-juridik.

Neni 6
Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Njoftimi publik do të kompenzohen në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse . Kompenzimi do të bëhet vetëm për anëtarët e komisionit të cilët nuk e kanë të ndaluar kompenzimin për kryerjen e shërbimeve shtesë konform dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 7
Hyrja në fuqi

1. Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Arsyetim

Baza juridike

Baza juridike për të propozuar Vendimin është e përcaktuar me dispozitat e nenit 58 shkronja h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 40 shkronja h.) e Statutit të Komunës së Lipjanit.

Baza juridike dhe obligimi ligjor për të miratuar këtë Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Komisioni vlerësues formohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak 15Nr.464-45591 të datës 12.11.2014 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme - lokaleve afariste të Komunës në ZK Magurë, përkatësisht për dy lokalet afariste të precizuara në paragrafin 1.7 të pikes 1 të Vendimit të cekur paraprak me sipërfaqe 17m² dhe 38 m², konform nenit 17 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me të cilin nen përcaktohet që për secilin vendim paraprak të Kuvendit të Komunës formohet komisioni vlerësues.

Anëtari i pestë i Komisionit nga subjekti joqeveritar lokal zgjidhet përmes shpalljes publike.

Lokalet e cekura afariste ka qenë të shpallura për tu dhënë në shfrytëzim edhe në vitet paraprake mirëpo nuk ka pasur palë të interesuara për të aplikuar dhe konsiderohet e nevojshme që të njëjtat të rishpallen .

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 020/04-56061
Lipjan, 07.11.2024

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12,14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 dt.4 qershor 2008, nenit 7 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 22 nëntor 2012, neni 4,5 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-623 të dt.26.09.2008, Kuvendi i Komunës në vazhdimin e seancës së dates 31. 10. 2014 me datë 06. 11. 2014 miratojë këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME-LOKALEVE AFARISTE TË KOMUNËS

1. Me këtë Vendim, i ipen në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik, paluajtshmeritë-lokalet afariste që gjinden në zonën kadastrale në Lipjan dhe Magurë si në vijim:

1.1. Lokalet afariste 3(tri) me sipërfaqe prej 35m²,35m²,8135m², gjinden në rrugën "Lidhja e Prizrenit" ngastradastrale P-71409044-01926-0 ZK Lipjan.

1.2. Lokali afarist me sipërfaqe prej 100m² gjindet në rrugën "Haradin Bajrami" ngastradastrale P-71409044-01307-1 ZK Lipjan.

1.3) Lokalet afariste 2(dy) me sipërfaqe prej 43m²,159m², gjinden në rr."Lidhja e Prizrenit" ngastradastrale P-71409044-01920-0 ZK Lipjan.

1.4. Lokali afarist 1(një) me sipërfaqe prej 48m², gjindet në katin përdhësë të ndërtesës së komunës rr.."Shqipëria" ngastradastrale P-71409044-01733-0 ZK Lipjan.

1.5. Lokali afarist 1(një) me sipërfaqe prej 120m², gjindet në rr.Sheshi "Adem Jashari" ngastradastrale P-71409044-01773-1 ZK Lipjan.

1.6. Lokali afarist 1(një) me sipërfaqe prej 54m², gjindet në katin e 4 (katër) në rr.Sheshi "Adem Jashari" ngastradastrale P-71409044-01799-0 ZK Lipjan.

1.7. Lokalet afariste 3(tri) me sipërfaqe prej 17m², 38m², 68m², gjinden në Magurë rr."Ruzhdi Shabani" ngastradastrale P-71409048-00097-0 ZK Magurë.

2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi pronat-lokalet afariste ipen në shfrytëzim në afat prej 10 vitesh nëpërmjet ankandit publik të përcaktuar sipas Rregullores QRK nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

3. Procedurën e ankandit publik e udhëheq Komisioni Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal 15Nr.404-13205 të dt.31.03.2014, në bazë të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektorit pronësoresh-juridik dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

5. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

15Nr. 464-45591

Lipjan, më 12.11 2014

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT

KRYESUESJA E KUVENDIT

Vlora Limani-Hajnuni

